

Informacion

Sipas marrëveshjes së MASH-it me Unionin e nxënësve të shkollave të mesme, KLMSH për gjuhë maqedonase, shqipe e turke dhe letërsi për sesionet e provimeve qershor/gusht 2023 iu qas ndryshimit të përmbajtjes së testit.

Komisioni ka përgatitur pyetje provimi me të cilat do të verifikohen objektivat e programit të provimit për aftësitë ekzistuese.

Përmbajtja e shkurtuar e testit për sesionet e provimeve qershor/gusht 2023 do të përbëhet nga pyetje në lidhje me:

- **Aftësia *Analizë letrare* do të verifikohet me pyetje nga:**

- Letërsia kombëtare me 1 përfaqësues;

- Letërsia botërore me 1 përfaqësues.

Pyetjet në lidhje me letërsinë botërore do t'i referohen listës së mëposhtme të autorëve dhe veprave:

- "Gilgameshi"; Homeri; Sofokliu; U. Shekspiri; Zh.B. Molieri; Xh.G. Bajron; A. Pushkini; F. Dostojevski; Edgar Alan Po; A. Kamy; A.P. Çehov.

- **Aftësia *Lexim-kuptim* do të verifikohet me pyetje që lidhen me:**

- dy (2) tekste me tema të ndryshme

- **Aftësia *Shkrim* do të verifikohet përmes shkrimit të 1 teksti.**

Nxënësit kandidatë do të kenë mundësinë të zgjedhin të shkruajnë për njërin nga dy temat e ofruara, në vetë ditën e provimit. Vëllimi i numrit të fjalëve është nga 250 deri në 400 fjalë.

Temat në të cilat do të duhet të shkruajnë përfshijnë jetën shoqërore-sociale të njeriut me theks në kuptimin e të rinjve për kushtet e theksuara shoqërore-sociale.

Gjatë shkrimit të tekstit, nxënësit duhet:

- të lexojnë me kujdes titullin dhe orientimet në mënyrë që të kuptojnë saktë kërkesën e temës;

- të përdorin orientimet që i marrin bashkë me titullin dhe po të njëjtat t'i shpërndajnë në kompozicionin e tekstit (hyrje; pjesa kryesore; përfundim);

- të dinë se përgjigjet në orientimet lidhen me kriteret e vlerësimit.

Sugjerime për shkrimin e tekstit mund të gjenden dhe të lexohen në ueb faqen www.matura.gov.mk/www.dic.edu.mk në dokumentet:

- [Informacion për kalimin me sukses të provimit të maturës;](#)

- [Sugjerime për përgjigje më të mira në pyetjet nga pjesa Shkrim \(për gjuhët amtare dhe të huaja\);](#)

- [Sugjerime për përgjigje më të mira në pyetjet e testit që lidhen me aftësinë Shkrim;](#)

- Udhëzim për shkrimin e një teksti me orientimet e dhëna.

• **Fusha gjuhë do të verifikohet me pyetje nga temat që përmban programi i provimit.**

Rekomandim për nxënësit - maturantët e ardhshëm

Maturantët e ardhshëm:

- do të duhet të shkruajnë me **shkrim dore** në gjuhën në të cilën po zgjidhin testin.
- nuk duhet të kopjojnë dhe nuk duhet të lejojnë dikë tjetër të kopjojë prej tyre;
- nuk duhet të përdorin tekste ose fjali të huaja (të shkruara tashmë nga një person tjetër);
- nuk duhet të marrin informacione të gatshme nga burime të ndryshme, edhe nëse bëhet fjalë për mendime të njohura nga një libër, nga një person - kjo konsiderohet vjedhje letrare - plagjiaturë. Për çdo tekst të marrë, do të duhet të përmendet burimi.
- nuk duhet ta shkruajnë emrin dhe mbiemrin në asnjë faqe të testit.

Në procesin e kontrollimit të testeve, vlerësuesit janë ata që do ta vërejnë këtë, ndaj në një situatë të tillë i gjithë testi do të vlerësohet me 0 pikë.

Nxënësit do të mund t'i përdorin materialet e vendosura në faqen tonë www.matura.gov.mk ose në www.dic.edu.mk që u referohen lëndëve të cekura për përgatitje të suksesshme të provimit të maturës, së bashku me orientimet që nxënësit i marrin nga profesorët e tyre në procesin mësimor.